



REPUBLIKA E KOSOVËS



**KOMUNA DRENAS
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM**

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës të dt.21.05.2008 në pajtim me procedurat ligjore, në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, përkatësisht të Nenit 79 rreth detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtori i DKA-së nxjerr këtë:

V E N D I M

Për legjitimimin dhe funksionimin e grupeve vullnetare në të gjitha institucionet arsimore të shkollimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë

-Me këtë Vendim, DKA zyrtarisht legjitimon dhe funksionon grupet vullnetare në të gjitha institucionet arsimore të nivelit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.

-Secili institucion arsimor aktivizon grupet e vullnetarëve prej 15 nxënësve më të dalluar në shkollë, si për nga suksesi, ashtu edhe për nga sjellja e tij, që njëherit janë si parakusht për të qenë pjesë e grupi vullnetar. Ndërsa një mësimdhënës vullnetar i shkollës përkatëse të jetë koordinator i grupit.

-Grupet vullnetare mund të kryejnë punë të ndryshme vullnetare që shkojnë drejtëpërdrejtë në interes të nxënësve dhe institucionit arsimor në përgjithësi.

-Për punën vullnetare nxënësit duhet të llogarisin vetëm kohën e lirë duke mos e penguar vetën dhe të tjerët në procesin e rregullt edukativo-arsimor.

-Grupet vullnetare mund të zgjerohen në nëngrupe, varësisht nga interesimi i nxënësve dhe nevojave të tjera të paraqitura në shkollë.

-Grupet vullnetare përmes koordinatorit të tyre për punën e vetë e paraqesin raportin me shkrim te Drejtori i Shkollës përkatëse, i cili në fund të muajit obligohet të paraqet raportin për punën vullnetare në DKA.

A R S Y E T I M

Vendimi i DKA-së për legjitimimin dhe funksionimin e grupeve vullnetare në të gjitha institucionet arsimore në Komunën e Drenasit vjen si rezultat i rrethanave të reja që Komuna e Drenasit është e e para dhe e vetmja në Republikën e Kosovës, rajon e më gjerë që i ka të formuara grupet vullnetare. Kjo risi ka zgjuar interesim të madh në Konferencën Ndërkombëtare të Punës vullnetare që është mbajtur në Strugë të Maqedonisë në muajin Maj 2009, ku përveç prezantimit të vacant që pati Republika e Kosovës në këtë Konferencë, Drenasi ka pasur prezantimin special si rast unikal.

Funksionimi i punës vullnetare të nxënësve në institucionet tona arsimore konsiderohet si veprim konkret për zhvillimin dhe funksionimin e sistemit arsimor të reformuar në Republikën e Kosovës, për krijimin e klimës psiko-sociale dhe ambiente të pastërta dhe të rregullta në të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe në përkrahje dhe gjithëpërfshirje të nxënësve në aktivitete të ndryshme shkollore që do të ndikojnë në realizim të objektivit të MASHT-it për ngritjen e cilësisë në arsim.

Ky vendim hynë në fuqi nga data 01.09.2009.

Drenas, më 31.08.2009



Drejtori i DKA-së:

Arsim Mehmeti, prof.